



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:241448
Datë: 30.01.2024
Numri i dokumentit: 05257847

C-IV-14-3008

Ankuesi

H L, Kamenicë

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha me 30 janar 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI045-0856, i datës 21 mars 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 18 prill 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. GJI045-0856, të datës 21 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me të cilin ka kërkuar kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 1,000.00 €, nga NSH “XIQ Karaqeva” (në likuidim). Ankuesi pohoi se në afatin ligjor ka parashtruar ankesë për kompensimin e për ndërprerjen e kontratës së punës, ashtu që në rastin konkret nuk mund të vij në shprehje parashkrimi i kërkesës. Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar kopjen e vendimit të kundërshtuar, si dhe letra për njoftimin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës e datës 15 gusht 2006.

Me 22 mars 2023, e paditura AKP-ja parashtroi mbrojtje në ankesë, në të cilën ka pohuar se AL-ja ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se pretendimet e ankueses janë të parashkruara, pasi që për të

ndërprerë afatin e parashkrimit kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjykatë apo në ndonjë autoritet kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtrueses që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit, e që është tre vite nga qershori 2008. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Me 07 dhjetor 2023, gjykata lëshoi urdhër për ankuesin, nga i cili kërkoi prova shtesë në mbështetje të ankesës. Ankuesi me 12 dhjetor 2023, e ka pranuar urdhrin e lëshuar nga gjykata, por i njëjti deri më tani nuk është përgjigjur në urdhrin e lëshuar nga gjykata.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH-ja i ka mbetur borxh për kompensim dëmi nga ndërprerja e parakohshme e kontratës së punës, po ashtu ankuesi nuk ka dorëzuar ndonjë specifikacion se për cilët muaj i kërkon pagat, ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesi ka dështuar që të ofrojë prova relevante lidhur me kërkesën për kompensim dëmi për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës edhe pas pranimin të urdhrin nga gjykata, duke mos u përgjigjur në të njëjtin. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksat gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e objektit të kontestit është nën 1,000.00 Euro.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare